



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH	NTSH "LIRIA" ("Ndërmarrja")
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndërmarrja e Re Liria "Prona në Jeni Mahallë" SH.P.K. (Ndërmarrja subsidiare) Ndërmarrja e Re e ofruar për shitje përfshin vetëm pronën e përkthyer si më poshtë. Asetet e ngelura të Ndërmarrjes nuk ofrohen për shitje, ato do të privatizohen veçmas.
Vendndodhja	Prizren, Komuna e Prizrenit
Biznesi/Spektori	Hapësirë për shitje me pakicë.
Prodhimet	Ndërmarrja lëshon me qira palëve të treta hapësirë për tregti me pakicë të cilën e shfrytëzojnë për aktivitete të ndryshme të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore. Prona që ndodhet në zonën primare të qytetit të Prizrenit. në Jeni Mahallë, përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 584m ² .
Tregu	Tregu i patundshmërive komerciale mund të ndahet në tregun me pakicë, për deponim/industri dhe hapësirë për zyre. Në Kosovë, dy segmentet kryesore të shitjes me pakicë janë ushqimi dhe veshmbathja. Shitjet tjera me pakicë përfshijnë shitoret e specializuara që shesin CD/DVD, barëra, artikuj argjendarie, pjesë për vetura dhe mobile. Tregu me pakicë në Kosovë është shumë i ndarë dhe dominuar nga biznese të vogla familjare.
Konkurrenca	Tregu i hapësirave me qira për shitje me pakicë në Prizren, sikur në tërë Kosovën, është shumë i ndarë dhe kompetitiv. Gjithashtu ndërmarrja ka një ndër portofolet më të mëdha individuale për shitje me pakicë në Prizren, ndërmarrja subsidiare përfaqëson vetëm një pjesë të vogël të tregut. Konkurrentët janë të ndryshëm dhe përfshijnë NSH të tjera, një numër të madh të investitorëve të pronës private, dhe një numër i vogël të pronarëve privat. Me rëndësi është të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e hapësirës me qira për shitje me pakicë ende i takon NSH-ve ku qiramarrësit rrallë i mbulojnë obligimet e veta të qirasë.
Punonjësit	Nuk ka asnjë punonjës të caktuar për njësinë e Ndërmarrjes. Ndërmarrja ka pasur 328 punonjës të cilëve më 30/11/2010 iu është ndërprerë marrëdhënia e punës në bazë të vendimit të AKP-së.

Rr. Pushkatarët nr 9
20000 Prizren, Kosovë
Tel: +381 (0)29 226 480
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në humtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërtesat dhe tokat

Ndërmarrja e Re Liria “Prona në Jeni Mahallë” është në emër të NSH “Liria”-Prizren në bazë të certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-71813068-01193-1 (F.P.nr.5310) dhe Kopjes së Planit të datës 06.03.2012 që përfshin ngastrën kadastrale nr. 1193-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 584m², prej të cilave 116m² me kulturë ndërtesë dhe 468m² me kulturë oborr.

Prona për tu bartur në Ndërmarrjen e Re përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 584m² dhe ndodhet në rrugën “Rrotullajt”, Jeni Mahallë në zonën primare të qytetit të Prizrenit.

NJOFTIM I RËNDËSISHEM: Në pronën e NTSH “Liria”-Prizren, që është lëndë e këtij tenderi, gjendet një godinë/ndërtesë e vjetër në të cilën jeton familja Alishani nga Prizreni. Kjo familje është vendosur në këtë ndërtesë për më shumë se 50 vite sipas një vendimit të BVI-së -Prizren për shfrytëzim në kohë të pacaktuar të banesës në sipërfaqe prej 39.5 m². Sipërfaqja e objektit prej 39.5m² për të cilin ekziston kontrata e BVI-se NUK i bartet blerësit të ri.

Blerësi i ri i kësaj Ndërmarrjeje të Re informohet për të drejtën e kalimit në pronë të familjes Alishani.

Detyrimet që do të barten

- (1) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të, **(nëse ka)**.
- (2) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri, **(nëse ka)**.
- (3) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-se në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
 - a. Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b. Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

Rr. Pushkatarët nr 9
20000 Prizren, Kosovë
Tel: +381 (0)29 226 480
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në humultimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Foto inqizimi ajror i Ndërmarrjes së Re



Informatat

Departamenti i Shitjes
Agjencioni Kosovar i Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 500 400

Dokumentet e ofertimit

www.pak-ks.org
Agjencioni Kosovar i Privatizimit
Rr: Ilir Konushevci Nr:8
10000 Prishtinë, Kosovë

Rr. Pushkatarët nr 9
20000 Prizren, Kosovë
Tel: +381 (0)29 226 480
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në humtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>